



Prishtinë, 30 prill 2010
Kodi i ZRRE-së: V_246_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

1. Nenin 22 paragrafi 6, Nenin 23 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.2004/9), të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Nenin 3 dhe Nenin 4 paragrafi 2 të Rregullës "Pasqyrë e taksave"; dhe,
3. Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010,

Në seancën e mbajtur me datë 30 prill 2010, nxori këtë:

VENDIM

LIROHEN nga pagesa e taksave vjetore të gjithë të licencuarit në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE), të përcaktuara sipas Pasqyrës së Takave, për periudhën nga data 01.04.2010 - 31.10.2010.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me qëllim të harmonizimit të *"Të Hyrave me Buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2010"*, liron të licencuarit nga pagesa e taksës vjetore të licencimit sipas rregullit "Pasqyrë e Taksave" si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që:
 - a) Të Hyrat e gjertanishme të mbledhura sipas Nenit 6 dhe 7 të Rregullës "Pasqyrë e Taksave" plotësojnë Buxhetin e planifikuar të ZRRE-së për vitin 2010.
 - b) Lirimi nga pagesa e kësaj takse për këtë periudhë, për ndërmarrjet që prodhojnë energji elektrike dhe termike do të reflektohet në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për periudhën e ardhshme të shqyrtimit të tarifave (viti 2011), përmes bashkërendimit të të Hyrave të Lejuara.
2. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar